


24.01.2018

NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PER KRIME TE

RENDË- sipas gjyqtarit Ibrahim Idrizi – kryetar i trupit gjyques, me zyrtaren ligjore Albana Ajvazi, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED]
[REDACTED] për shkak të veprës penale grabitja nga neni 329 par 3 lidhur me par. 1 në bashkëkryerje sipas nenit 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 te KPRK-së, për të akuzuarin [REDACTED]

[REDACTED], sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, PPI.nr.211/2017 të datës 10 Janar 2018, pas mbajtjes se shqyrimit filletar më 24 janar 2018 në prani të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

[REDACTED] i biri i [REDACTED] e ema [REDACTED], e vajzeris [REDACTED], i lindur me dt. [REDACTED], në fshatin [REDACTED] komuna [REDACTED] ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka te kryer shkollën fillore, me pseudonimin [REDACTED], i pa punësuar, i pa martuar, me gjendje te mesme ekonomike, gjendet ne paraburgim nga data 14.12.2017

[REDACTED] i biri i [REDACTED] e ema [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], i lindur me dt. [REDACTED], në fshatin [REDACTED] komuna [REDACTED] ku edhe jeton, pa pseudonim, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka te kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i martuar, pa femije, me gjendje te dobet ekonomike, gjendet ne paraburgim nga data 19.12.2017

J a n ë f a j t o r

[REDACTED] dhe [REDACTED]

Se më dt. 14 dhjetor 2017, rrëth orës 02:30, në kazinon "Matrix" në rr. "Adem Jashari" në Shtime, me anë të kanosjes serioze për ta sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër me qëllim që ti sjellin vetes dobi pasurore të kundërligjshme, në të mënyrë që pasi te njëjtit paraprakisht kane bere planin per kryerjen e veprës penale të grabitjes, pas marrjes se udhëzimeve dhe mjetit – veturën nga i pandehuri [REDACTED], të pandehurit te maskuar dhe

me revole kanë hyrë në kazino, nën kërcënimin e armës, kanë kërkuar nga i dëmtuari [REDACTED] që të shtrihet ne tokë, në ato momente i dëmtuari [REDACTED] i drejtohet me fjalët "O [REDACTED]", i pandehuri i dytë i është ofruar të dëmtuarit dhe e godet me grusht në fytyrë si dhe e drejton revolen në drejtim të tij, kurse i pandehuri i pare nën kërcënimin e armës e detyron [REDACTED] që ta hap arkën, ku nga arka marrin 5904€, pastaj të dëmtuarit i mbyllin në depo dhe largohen nga kazino

-me këtë ka kryer veprën penale në bashkëkryerje grabitje nga neni 329 par. 3 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPRK-se.

[REDACTED]
Se nga data, muaji dhe viti i pa vërtetuar deri me datë 14 dhjetor 2017, në mënyre të paautorizuar e në kundërshtim me lidhin mbi armët ka mbajtur në posedim armët – pistoleta e tipit "Dynamit R.WS- Model-C225" me numër serik E23503041 dhe pistoleta e tipit "Walther-Model PPK" e kalibrit 7.65mm, me numër serik 189123, një karikator dhe 7 cope fishek, të cilat armë janë përdorur me rastin e grabitjes, me ç'rast të njëjtat sekuestrohen përkohësisht nga policia.

-me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-se.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 31, 41, 43, 45, 46, 73, 75, 76, 80, 83 e 329 e 374 të KPRK-së si dhe te nenit 365 të KPPK-së,

Për të akuzuarin [REDACTED]

Konstaton:

- Për veprën penale grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-se dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 4 vite e 3 muaj dhe dënim gjobe ne shume prej 1.500€

- Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-se dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 5 muaj.

Dhe gjykata ne baze te nenit 83 si dhe te dispozitave te cekura ligjore,

I g j y k o n

Te akuzuarin [REDACTED] me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim gjobe ne shume prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro

Të akuzuarin [REDACTED] me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim gjobe ne shume prej 1.000(njëmijë) euro.

Në dënimin e shqiptuara me burgim të akuzuarve do tu llogaritet koha e kaluar ne paraburgim prej datës 14.12.2017 për të akuzuarin [REDACTED] dhe prej datës 19.12.2017 për të akuzuarin [REDACTED] derisa aktgjykimi te merr formën e prere por jo me shume se dënim i shqiptuar me këtë aktgjykim.

Në rast se dënimet me gjobë nuk mund te ekzekutohen ne asnjerën prej formave te parapara me nenin 46 të KPRK-se, dënimet me gjobë do të zëvendësohen me dënim burgimi duke llogaritur nga 20 Euro për çdo dite burgimi.

Konfiskohen në mënyrë të përhershme armët – pistoleta e tipit “Dynamit R.WS-Model-C225” me numër serik E23503041 dhe pistoleta e tipit “Walther-Model PPK” e kalibrit 7.65mm, me numër serik 189123, një karikator dhe 7 cope fishek.

Obligohen te akuzuarit që kësaj gjykate t'i paguajnë shpenzimet për paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 euro secili.

Të dëmtuarit [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] për të realizuar kërkesën pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

A r s y e t i m i

Histroiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Renda, ka ushtruar aktakuzën P.P.I. nr 211/2017 të datës 10.01.2018 ndaj të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale grabitja nga neni 329 par 3 lidhur me par.1 në bashkëkryerje sipas nenin 31 të KPRK-së, për te akuzuarin [REDACTED] për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se dhe [REDACTED] për veprën penale ndihme ne kryerjen e veprës penale te grabitjes nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 33 të KPRK-se.

Duke vepruar sipas kësaj akuze, në këtë Gjykatë me 25 janar 2018 është mbajtur shqyrtimi fillestare sipas dispozitave të nenit 245 te KPPK-së.

Pranimi i fajësisë nga të akuzuarit

Të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] në shqyrtimin fillestare e kanë pranuar fajësinë për veprën penale grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-se, dhe i akuzuari [REDACTED] edhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-se, të cilat iu vihen ne barrë me aktakuzën e prokurorit te shtetit.

Kanë deklaruuar se është hera e parë që kryen vepër penale, janë penduar për kryerjen e kësaj vepre dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të natyrës së tillë apo vepra tjera penale.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Kryetari i trupit gjykues në shqyrtimin fillestare konstatoi se të akuzuarit e kane pranuar fajësinë pasi që kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimin i fajit e kanë bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve me mbrojtësit e tyre, si dhe pranimi i fajit është mbështetur në të gjitha faktet dhe provat e paraqitura nga prokurori në aktakuzë dhe me këtë janë përmbushur te gjitha kushtet ligjore te parapara në nenin 248 te KPPK-së, dhe në këtë mënyrë shqyrtimin fillestare e ka përfunduar pa administruar provat e tjera dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 248 të KPPK-së.

Vlerësimi ligjor i vepprimeve të të akuzuarit

Kryetari i trupit gjykues po ashtu konstatoi se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale grabitja nga neni 329 par 3 lidhur me par. 1 në bashkëkryerje sipas nenit 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 te KPRK-së, për të akuzuarin [REDACTED], për të cilat vepra të akuzuarit janë penalisht përgjegjës dhe janë ndëshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i dënimit për të akuzuarit

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 i KPRK-se, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka marr për bazë pranimin e fajësisë nga të akuzuarit dhe faktin se nuk ka aktgjykim të formës së prerë për ndonjë dënim të mëparshëm, ndërsa si rrethanë renduese

gjykata pati parasysh kohën e kryerjes së veprës penale ora 02:30, mënyrën e kryerjes së veprës penale, të akuzuarit të maskuar me revole në duar e kanë shtrirë për toke të dëmtuarin [REDACTED], e kanë qëlluar me grusht në fytyrë dhe ia kanë drejtuar revolen me kërcënim, duke e rrezikuar kështu jetën e të dëmtuarit si një ndër vlerat më kryesore të njeriut, të mbrojtura në përgjithësi dhe të rrezikuara konkretisht me veprimet konkrete.

Gjykata është e bindur se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë në harmoni me peshën e veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe varësish prej veprimeve dhe rolit të secilit prej të akuzuarve në kryerjen e veprës penale të grabitjes, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese gjykata ua zbuti dënimet siç parashihet ne nenet 75 par. 1 neni par. 1.3 e 76 par. 1 nen par. 1.2 te KPRK-se, me bindje se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, duke i shërbyer preventivës speciale-që të akuzuarit në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale dhe duke ndikuar te personat e tjerë që të mos kryejnë vepra të tillë penale-preventiva gjenerale.

Vendimi për sekuestrim bazohet në nenin 374 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar ne nenin 453 par.1 të KPPK-se.

Vendimi për kërkesën pasurore – juridike është i bazuar në nenin 463 par. 2 të KPP-së

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**

PKR. 1/18

Më datë 24 janar 2018

Zyrtare ligjore,
Albana Ajvazi

Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari,
Ibrahim Idrizi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te ushtrohet ankesë në afat

prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, në
Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në drejtim të sanksionit penal.